



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1019/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Florije Krasniqi, duke vendosur përkitazi me apelet: e Valon Maliqi sekretar i subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë dhe Jeton Biçkaj sekretar i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, pas shpalljes e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarë të Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohen si të bazuara apelet e Valon Maliqi sekretar i subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë dhe Jeton Biçkaj sekretar i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë me shenjat ZL.Anr.1019/2017, dhe ZL.Anr.1020/2017 të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarë të Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj fletëvotimet me kusht dhe fletëvotimet e votuesve jashtë Kosovës (me post), për të gjithë kandidatët e subjekteve politike për anëtar të Kuvendit Komunal në Kamenicë, si dhe fletëvotimet me kusht dhe fletëvotimet e votuesve jashtë Kosovës(me post), për të gjitha subjektet politike në Kamenicë.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kuti në Vendvotimin si në pikën - II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelet e Valon Maliqi sekretar i subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë dhe Jeton Biçkaj sekretar i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë. Parashtresit e këtyre apeleve pretendojnë se në Formularët e Rezultateve të Kandidatëve-FRK subjekti politik Nisma për Kosovën posedon 308 vota të rregullta, 4 vota me kusht dhe 0 vota nga

votuesit jashtë Kosovës, gjithsej 312 vota. Ndërsa pas shpalljes e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarë të Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, subjekti politik Nisma posedon 318 vota gjë që ka ndikuar që subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR) të dëmtohet për një anëtarë në Kuvendin Komunal në Kamenicë. Parashtruesit e apeleve kanë bashkangjitur apeleve listat e kandidatëve në Komunën e Kamenicë në të cilën pretendon se ka pasur parregullsi.

Në apel kërkon nga PZAP-i që të bëhet rinumërimi i votave në vendvotimet e cekura.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartcekura dhe i trajton si një apel i evidentuar me ZL.Anr.1019/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për 2 apele që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apelet janë të bazuara

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, për faktin nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, ka vërtetuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, andaj mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në, që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve me kusht dhe fletëvotimet e votuesve jashtë Kosovës për të gjithë kandidatët e subjekteve politike për anëtarë të Kuvendit Komunal në Kamenicë, si dhe fletëvotimet me kusht dhe fletëvotimet e votuesve jashtë Kosovës për të gjitha subjektet politike në Kamenicë siç është cekur më lartë në pjesën II të dispozitivit të vendimit dhe rezultati i dalur nga rinumërimi të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të datës 22.10.2017.

PZAP-i vendimin e vet e bazon në dispozitën nenit 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Nga sa u tha mësipër në mbështetje të nenit 117.4, 115.1 dhe 118.1 e LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr. 1019/2017 më datën 12.11.2017.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

